



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2021:036032

Datë: 03.04.2024

Numri i dokumentit: 05537479

P.nr.73/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti I Pergjithshem-Divizioni Penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa, në çeshtjen penale ndaj të pandehurit S.K nga fsh...-Kaçanik, i akuzuar për veprën penale, Rrezikim I trafikut public nga neni 370 par.9 lidhur me par.1 dhe 6 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1513/20 të datës 11.03.2021, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me dt.21.02.2024, në prezencë të Prokurorit të shtetit Albert Zejnullahu dhe të pandehurit me mbrojtësin me autorizim, av. N. R., në mungesë të përfaqësuesit të familjes së dëmtuar, me dt.23.02.2024 mori dhe shpalli , ndërsa me dt.22.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri S.K nga fsh....-Kaçanik, i lindur më dt..., nga i ati A... dhe e ëma S..., e gjinisë C..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosoves, i martuar, prind i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar në kompaninë "..., i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal:

ËSHTË FAJTOR

Sepse me dt. 11 Tetor 2020, rreth orës 18:50, e ka drejtuar traktorin e markës "...", ngjyrë e kaltër, pa targa, në kundërshtim me nenin 112 par. 1 nënpar.1.3 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, ashtu që ka lëvizur me traktorin e lartëcekur me mjet bashkangjites-rimorkio në rrugën magjistrale, pa sinjalizim të ndritshëm, për pasojë me të arritur te depoja ndërtimore "Jehona", komuna Kaçanik, goditet nga automjeti, i markës "...", me targa ..., ngjyrë e bardhë, ku si rezultat i kësaj goditje drejtuesi i automjetit, M. L., fillimisht, dërgohet në Emergjencë në Ferizaj, e pastaj në QKUK në Prishtinë, derisa me dt. 15.10.2020 edhe ndërron jetë.

Me këtë veprim, i pandehuri ka kryer veprën penale, Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370 par. 9 lidhur me par. 1 dhe 6 të KPRK-së.

Prandaj gjykata, në bazë të nenit 2,7,38,43,44,69,70,71 par.1 nënpar.1.2 dhe neni 72 par.1 nënpar.1.5 të KPRK-së, dhe neni 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

G J Y K O N

Me dënim me burgim ne kohezgjatje prej 180 ditësh, i cili dënim konfor neni 44 par.1 dhe 2 të KPRK-së, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 4500.00 €.

I pandehuri është i obliguar që dënimin me gjobë t'a paguajë pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, ne afatin prej dhjetë (10) muajve dhe ate në dhjetë (10) këste.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën, gjykata do t'a zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur shumën prej 20 € për çdo ditë burgu.

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguajë pranë kësaj gjykate shumën prej 1,182.86 €, kurse në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 50,00€, ndërsa për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 30.00 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

I dëmtuari G.L., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën, PP/II.nr.1513/20 të datës 11.03.2021, të pandehurin S.K nga fsh....-Kaçanik, e ka akuzuar për veprën penale Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370 par. 9 lidhur me par. 1 dhe 6 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që I njëjti të shpallet fajtor dhe të gjykohet sipas ligjit.

Ne bazë të kësaj aktakuze, gjykata caktoi dhe mbajti senacën e shqyrtimit fillestar me dt.31.08.2022, me të cilin rast pas prezentimit të aktakuzës nga prokurori I shtetit, I pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur lidhur me këtë çështje penale, prokurori I shtetit mbeti në tërësi pranë aktakuzës së parashtruar me shkrim pranë kësaj gjykate, të korigjuar në seancën e shqyrtimit fillestar. Në fjalën e tij përfundimtare theksoi se, pas adminstrimit të provave gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe vlerësimit të tyre veq e veq dhe të gjitha në tërësi, është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mire se I pandehuri S.K, e ka kryer veprën penale, Rrezikim I trafikut public nga neni 370 par.9 lidhur me par.1 dhe 6 të KPRK-së. Në fjalën e tij perokurori ka theksuar se, gjatë shqyrtimit gjyqësor, me rastin e ndëgjimit të ekspertit të komunikacionit Prf.Dr. N. L., ky I fundit ka sqaruar se traktori të cilin e ka drejtuar I pandehuri, I cili ka patur të bashkangjitur rimorkio, nuk ka patur të vendosura dritat ose ndonjë shenjë reflektuese ose trekeëndë I cili do t’I sinjalizonte pjeëmarrësit në komunikacion gjatë natës. Prandaj sipas ekspertit në fjalë, aksidenti ka ndodhur si pasojë e lëshimeve të të dy pjesëmarrësve në komunikacion dhe ate drejtuesit të traktorit I cili ka lëvizur me traktor pa sinjalizues dhe drejtuesit, tani të ndjerë të automjetit të automjetit të markës “...” për shkak të mosrespektimit të kufizimit të shpejtësisë dhe mosreagimit me kohë. Prokurori, në fjalën e tij ka theksuar se, edhe vetë I pandehuri në deklarinimin e tij ka treguar se mbrapa në rimorkion e traktorit ka patur të vendosur një najlon për t’I sinjalizuar pjesëmarrësit tjerë. Prokurori poashtu ka theksuar se gjendja faktike, është vërtetuar edhe nga provat material si:

Raporti mjekësor I lëshaur nga Spitali I Përgjithshëm në Ferizaj nr.prot.827 I dt.11.10.2020, raporti për konstatimin e vdekjes, çertifikata e vdekjes e dt.19.10.2020, raporti I autopsisë I

dt.16.10.2020, ekspertizat e komunikacionit si: ekspertiza e komunikacionit e dt.25.11.2020 e ekspertit Xh. H., ekspertiza e komunikacionit e dt.11.01.2021 e ekspertit F.H., ekspertiza e grupit të ekspertëve: F. S., G. H. dhe V.B. e dt.15.02.2021, si dhe super ekspertiza e hartuar nga fakulteti I Inxhinierisë Mekanike me nr.prot.0124 e dt.26.09.2023, si dhe nga konstatimi I raportit të autopsies ... I dt.16.10.2020 të dr. N. U., në të cilin konstatohet se vdekja e të ndjerit m. L., ka ardhur si pasojë e gjakderdhjes trunore dhe torakale, si pasojë e thyerjes serike complete të brinjve dhe dërrasës së gjoksit. Prandaj, prokurori I shtetit ka kërkuar nga gjykata, që të pandehurin t'a shpall fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet dhe të njejtit t'I shqiptohet sanksion penal, me të cilin në tërësi do të arrihet qëllimi I dënimit, ashtu që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, të merren parasysh rrethanat rënduese , derisa si rrethanë lehtësuese, të vlerësohet shprehja e keqardhjes nga I pandehuri dhe kërkim falja familjes së të ndjerit.

Përfaqësuesi I familjes së dëmtuar, G. L., në fjalën e tij në shqyrtimin gjyqësor, nuk I bashkangjitet ndjekjes penale, derisa kërkesën pasurore juridike do t'a realizojnë në contest civil.

I pandehuri në fjalën e tij në shqyrtimin gjyqësor, nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet. Në mbrojtjen e tij ka theksuar se, ditën kritike ka qenë në fsh. ...- Kaçanik, duke punuar si punëtor fizik, dhe pasi që e kishte kry punën dhe me urdhër të shefit të tij, ka patur obligim që t'a dërgojë traktorin në shtëpi, dhe është nis nga fsh... rreth orës 18:20 min, ka vazhduar rrugën nëpër pjesën e qytetit të Kaçanikut deri në rrugën maagjistrale, pa patur ndonjë problem, për të vazhdu rrugën deri në fsh. ..., por derisa ka qenë duke lëvizur në rrugën magjistrale, vetëm kur e ka ndëgjuar një zhurmë të madhe, si tërmet, dhe nuk e ka ditur se çka ka ndodh, por në momentin kur është kthyer mbrapa e ka vërejtur qe automjeti I markës "...” ishte ngjitur në rimorkion e traktorit të tij. Pa skësaj është ndalur dhe ka shku te shoferi, dhe në ndërkohë janë ndal edhe njerz të tjerë dhe pasi që I kanë dhënë ujë të pandehurit meqë është ndier I traumatizuar, është njoftu edhe policiaa, zjarrfikësit, ndërsa I pandehuri nuk është lejuar që të prek automjetin ose shoferin e automjetit "...”. I njejtë në mbrojtjen e tij poashtu ka theksuar se, familjarët e tij (babai dhe vëllau) te njëjtën natë kanë shkuar te spitali me për t'u interesuar për gjendjen shëndetësore të të dëmtuarit, ndërsa I pandehuri është intervistuar per rastin konkret. I pandehuri poashtu thekson faktin se, prej asaj dite normalisht që e ka ndier veten keq për rastin dhe vazhdon tá ndien veten keq, dhe se pas aksidentit ka patur stres dhe probleme me gjumin ka qëndru në shtëpi, por edhe ka patur dhimje të qafës,

ndërsa i ndjeri jetoi vetëm 4 dite pas aksidentit dhe pastaj ndërroi jetë. Ndersa sa u përket raporteve me familjarë e të ndjerit nuk kanë patur ndonjë problem, përkundrazi janë takuar, kanë pirë kafe, dhe se janë lejuar nga familja e të ndjerit që të marrim pjesë edhe në ceromoninë e varrimit.

I njeti poasht ka theksuar se, nuk ka qenë në dijeni se nuk e ka patur të lejuar që të dal në komunikacion me traktorin e tij bashkë me rimorkio pa sinjalizimin e duhur, edhe pse konfirmon se I njeti në atë kohë ka qenë I pajsur me patent shofer të kategorisë “B” por megjithate ka vlerësuar se kesja e najlonit me ngjyrë të verdhë do të shërbejë mjaftueshëm si sinjalizim .

Mbrojtësi i të pandehurit në fjalën e tij perfundimtare deklaroi se, nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, Prokuroria nuk ka arritur që të argumentojë se I mbrojturi I tij e ka kryer veprën penale e cila I vihet në barrë për arsye se nga superekspertiza e dt.26.09.2023 dhe as nga dëgjimi I ekspertit në senacën e dt.15.02.2024, janë vërtetuar pretendimet e mbrojtjes, se aksidenti I dates 11.10.2020 nuk është shkaktuar nga veprimi apo mosveprimi I të mbrojturit të tij, e poashtu as pasoja e shkaktuar. Kjo pasi që në faqen nr.16 të kësaj superekspertize të dt.26.09.2023 e përpiluar nga grupi I eksperteve, është përcaktuar saktë se “Sikur ngasësi I veturës ... të reagonte me kohë, me system të frenimit dhe të lëvizte me shpejtësi sa shpejtësia e lejuar, nuk do të vinte fare deri te aksidenti”, me çka vërtetohet se aksidenti I komunikacionit I dt.11.10.2020 nuk është shkaktuar fare nga I pandehuri, prandaj nuk qëndrojnë fare pretendimet e Prokurorisë se I pandehuri ka shkaktuar veprën penale , Rrezikim I trafikut public nga neni 370 par.9 të KPRK-së, sepse në rastin konkret aksidenti ka patur mundësi teknike të shmanget nga I ndejri, sikur të zhvillonte shpejtësi maksimale të lejuar prej 60 km/h ose të frenonte me kohë. Mbrojtësi, në fjalën e tij ndër të tjera, ka theksuar se, në senacën e dt.15.02.2024, eksperti ka sqaruar se drejtuesi I veturës “...”ka patur kohën e mjaftueshme për të reaguar me kohë, edhe duke zhvilluar shpejtësi prej 75 km/h, ka qenë e mundur që të shkaktojë aksidentin, por pasojat do të ishin vetëm disa gërvishtje. Prandaj eksperti gjatë elaborimit të tij precizon se “faktori kryesor për pasojat me fatalitet janë shpejtësia e lartë dhe mosreagimi me kohë I automjetit ...”. Mbrojtësi më tutje thekson se, në rastin konkret, mungon figura e veprës penale ashtu siq është përcaktuar me Kodin Penal të republikës së Kosovës, poashtu në rastin konkret mungon kauzaliteti apo lidhja shkakësore mes veprimeve të të pandehurit dhe pasojës së shkaktuar, meqë pasoja e shkaktuar ka ardhur si pasojë e dy komponenteve, të sqaruara edhe nga eksperti në senacën e dt.15.02.2024 dhe ate shpejtësia e lartë dhe mosreagimi me kohë I të ndejrit dhe jo nga veprimi apo mosveprimi I të pandehurit..

Mbrojtësi poashtu thekson se kjo vepër penale kryehte me dashje eventuale, kur kryesi është I vetëdijshëm se me drejtimin e tillë të mjetit motoric, mund të sjell rrezik konkret për jetën, integritetin trupor të dikut, por shpreson se çdo gjë do të përfundojë në suaza të rrezikut konkret, se nuk do të ndodh lëndimi apo vdekja e ndokujt, mirëpo ai edhe pse e sheh një probabilitet të madh si të mundshëm në shkaktimin e pasojës, megjithate vazhdon të mos heq dorë nga një drejtim I tillë I mjetit. Në rastin konkret tek I pandehuri nuk kanë ekzistuar fare këto komponentë, sepse nga deklarata e e këtij të fundit si në stacion policor, prokurori ashtu edhe në gjykatë, ka spjeguar qartë dhe sinqerisht se “mbrapa në rimorkio ka vendosur najllon të verdhë, duke e konsideruar të mjaftueshëm për të sinjalizuar mjetet mbrapa tij dhe për t’i lajmëruar të njejtit për rimorkion”ku vërehet qartë se nuk ka ekzistuar dashja eventuale, epërshkruar si më lartë. Derisa dashja eventuale ka ekzistuar te drejtuesi I automjetit .., tani I ndjerë, sepse I njejtë me tejkalimin e shpejtësisë ka pare një probabilitet të madh si të mundshëm në shkaktimin e mundshëm të pasojës, megjithate ka vazhduarduke mos hequr dorë në drejtimin e mjetit me shpejtësi mbi 75 km/h. Andaj bazuar në të lartëcekurat, I propozon gjykatës që bazuar në nenin 363 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, të pandehurin S.K, t’a lirojë nga përgjegjësia penale për veprën penale për të cilën akuzohet, në mungesë të provave fajësuese.

Fjala e mbrojtësit mbështetet në tërësi edhe nga I pandehuri.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor prezantoi provat e propozuara me ndëgjimin e ekspertit të komunikacionit si mbikqyrës I superekspertizës, Prof. Dr. N. L., shiqimin e fotografive dhe skicimit të vendit të ngjarjes, raporti mjekësor I lëshuar nga Qendra Emergjente e Spitalit të Përgjithshëm Ferizaj, raporti për konstatimin e vdekjes,lëshuar nga QKUK-Prishtine,raporti i autopsise leshuar nga IML –Prishtine, ekspertiza nga eksperti i komunikacionit Xh. H. e dt. 25.11.2020, ekspertiza nga eksperti i komunikacionit, F. H. e dt. 11.01.2021, ekspertiza e aksidentit te komunikacionit rrugor nga grupi i eksperteve: F. S. ,G. H. Dhe V.B. dt. 15.02.2021.dhe superekspertiza mbi aksidentin e komunikacionit te Fakultetit Inxhinerise Mekanike e dt. 22.09.2023, me nr.prot.0124 dt.26.09.2023.

Esperitit i komunikacionit, Prof.Dr. N. L. gjatë shqyrtimit gjyqësor, deklaroi se me rastin e hartimit të superekspertizës për rastin konkret, si grup I ekspertëve, analizojnë ne detale analizën kohore dhe hapësinore (kriterin teknik te shmangjes se akcidentit qe bazohet ne analizën kohore dhe hapsinore) e cekur ne faqen 14 pika 2..3 dhe në rregullativën ligjore, gjithnjë duke patur parasysh literaturën shkencore e cila është potencuar në faqe 3, ku është

cituar literatura e Prof..Dr.Dr. F. R., derisa në faqen 2 të ekspertizës, janë shënuar te dhënat të cilat kanë qenë ne disponim për ata si ekspertë . Megjithate, si ekspertë kanë detyrë secili prej tyre, që t'a trajtojnë lëndën në mënyrë të pavarur në bazë të dosjes së ofruar nga ana e gjykatës, e kurrësi të mos bazohen në ekspertiza të mëhershme, edhe pse duke qenë si pjesë e materialit, këto ekspertiza, përfshi edhe ekspertizën e mbrojtjes, me rastin e hartimit të superekspertizës janë konsultuar në kuadër të të gjitha shkresave të lëndës.

Eksperti, ka sqaruar se meqë nuk kanë patur të dhëna raporti I Policisë së Kosovës, lidhur me vendosjen e rripit të sigurisë, prandaj edhe është konstatuar si e paplotësuar, derisa sa I përket çështjes së ndriqimit të rrugës, ka theksuar se ndriqimi i rrugës bëhet gjithmonë me drita të gjata, këtë e përcakton ligji, mirëpo gjatë shqyrtimit të analizës kohore dhe hapësinore janë bazuar në literaturën e autorit të lartecur siq është cituar ne paragrafin e 1 dhe 2 faqja 14, të cilat paragrafe janë të domosdoshme gjatë trajtimit të aksidenteve të ndodhura gjatë ngasjes natën. Me rastin e paraqitjes së pengesave të pandrikuara, eksperti me tutje shton se bazuar ne deklaratën e të pandehurit të dhënë ditën kritike, i njëjti ka theksuar se ka pasur të ndezura vetëm dritat para, ndërsa nuk ka patur drita të ndezura në pjesën e pasme të traktorit dhe as në pjesën e pasme të rimorkios së improvizuar dhe nuk ka patur as trekëndësh të sigurisë, prandaj ne rastin konkret nuk është plotësuar asnjë kusht i sinjalizimit dhe ndriqimit nga ana e vozitësit të traktorit . prandaj ky lëshim është potencuar dhe ka paraqit nje rrezik të përgjithshëm, mirëpo si grup i ekspertve kanë analizuar edhe mundësitë teknike për evitim të aksidentit nga ana e drejtuesit të veturës "... “ ,dhe ka rezultuar se, nëse ky I fundit do të vepronte me kohe me sistem të frenimit dhe të lëvizste me shpejtësi sa ka qenë shpejtësia e kufizuar 60 km/h, nuk kishte me ardh deri te aksidenti. Në elaborim të kësaj analize të shpejtësia prej 60 km/h , distanca me e afërt që kishte me ju afër është 10.97 m, duke përdorur edhe regjimin e dritave të shkurta dhe frenimin e vrullshëm dhe të reagoje me kohë, po ashtu është analizuar edhe shpejtesin prej 75 km/h , dhe kanë ardh në përfundim të dy elementet e lartecurura si reagimi me kohe dhe frenimi i vrullshëm, dhe në rastin konkret do të vinte deri te aksidenti por që (referuar faqes 15) të raportit, te koha prej 2.4 sekondave do t'a godiste traktorin me shpejtësi prej rreth 46 km/h , por pasojat do të ishin me te vogla. .Eksperti po ashtu sqaron se nëse ngasësi i automjetit të markës "... “ do t'i kishte patur të aktivizuara dritat e gjata, sipas literaturës, pengesa e njejte vërehet në distancë minimale prej 50 m, ndërsa me drita të shkurta 26-30 m.

Eksperti më tutje sqaron se, si grup I ekspertëve vlerësojnë se faktori kryesor për pasojat me fatalitet është mosreagimi me kohë (fare), ndërsa sa i përket shpejtësisë së sigurisë, respektivisht shpejtësisë në të cilën nuk do të vinte deri te aksidenti nga përlllogaritja ka dal se është 62 km/h dhe me qfarëdo shpejtësie më të vogël se 62 km/h do të evitohet aksidenti, që i përgjigjet rastit që nga drejtimi i kundërt të mos ketë patur ndonjë automjet duke lëvizur me drita të gjata dhe referuar në (faqen 16 par. 1 i 2.4). dhe në rastin konkret kishte me ndodhur kontakti fizik në mes traktorit dhe "...”por pa dëmtime (deformime).

Në fjalën e tij, eksperti thekson se në rastin konkret vozitësi i traktorit ka krijuar rrezik të përgjithshëm në komunikacion, ndërsa vozitësi I automjetit të markës "...” nuk ka respektuar shpejtësinë e lëvizjes të kufizuar deri në 60 km/h, dhe nuk ka reaguar me kohë me frenim, dhe kjo nënkupton që aksidenti është shkaktuar nga lëshimet e të dy pjesëmarrësve, duke shpjeguar edhe mundësinë e shmangies së aksidentit.

Eksperti poashtu sqaron për gjykatën se, poqëse traktori do t'i kishte të ndezura dritat, dukshmëria minimale me drita të shkurta për automjetin "...” do të ishte 40 metra ndërsa maksimumi 80 metra, derisa në rastin konkret është marrë distanca e dukshmërisë prej 28 metra, por që në vendin e ngjarjes nuk ka patur asnjë gjurmë frenimi dhe të manovrimit, nga ana e automjetit "...”.

Nga ndëgjimi I ekspertit në gjykatë, Prof.dr.N. L., gjykata vërtetoi se, ditën kritike, në rrugën magjistrale Kaçanik - Ferizaj, përballë deponës ndërtimore "...”, aksidenti ka ndodhur në momentin kur drejtuesi I traktorit duke tërhequr rimorkionin e improvizuar, të pandrikuar dhe shënuar me sinjalizim adekuat në kushtet e natës, goditet në pjesën e pasme të rimorkios me pjesën e përparmë të automjetit të markës "...” I cili ka qenë duke lëvizur në të njëjtin drejtim me traktorin, si pasojë e të cilit lëndime vdekjepruese ka marrë drejtuesi I automjetit të markës "...”ndërsa dëmet të mëdha materiale janë shkaktuar në veturë dhe qerren me dy rrota. Nga ky ekspert gjykata poashtu vërtetoi se, shpejtësia e lëvizjes së shpejtësia e lëvizjes së traktorit ka qenë rreth 25km/h, ndërsa shpejtësia e lëvizjes së automjetit të markës "...”ka qenë 75 km/h, derisa shpejtësia e lejuar, me shenjë të komunikacionit, ka qenë 60 km/h, dhe poqëse drejtuesi I automjetit të markës "...”do të respektonte shpejtësinë e lëvizjes të kufizuar për atë pjesë të rrugës, dhe të vepronte me kohë me sistem të frenimit, nuk do të vinte deri te aksidenti. Gjithsesi, në rastin konkret, pas ndëgjimit të ekspertit në fjalë, gjykata vërteton se aksidenti në fjalë, është shkaktuar nga lëshimet e të dy pjesëmarrësve, dhe atë të drejtuesit të traktorit, I cili

ka lëvizur natën në rrugën magjistrale me traktor pa sinjalizim adekuat, gjegjësisht pa drita dhe shenja që informojnë prezencën e tij në rrugë, dhe me lëshimet e drejtuesit të automjetit të markës “...”I cili nuk ka respektuar shpejtësinë e lëvizjes prej 60 km/h, duke lëvizur në shpejtësi prej 75 km/h, dhe duke mos reaguuar me kohë me sistem të frenimit.

Gjykata i fali besimin, deklaramit të ekspertit, meqë i njejtë në mënyrë të qartë ka spjeguar të gjitha rrethanat e ndodhjes së aksidentit, në pyetjet e palëve dhe gjykatës, dhe se mendimi I tij përveq që ka qenë në përputhje me superekspertizën e dt.22.09.2023, e cila është punuar, përveq ekspertit të ndëgjuar, Prof.dr. N. L., edhe nga eksperti Mr.sc.H. P. dhe Msc.E. Q., gjen mbështetje edhe në provat tjera të bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe ate ekspertizën e punuar nga grupi I ekspertëve, Msc. F. S., Dr.sc. G. H. dhe Dr.sc. V. B., të dt.15.02.2021, si dhe pjesërisht edhe në ekspertizën e ekspertit të komunikacionit Msc. F. H. të dt.11.01.2021, ekspertizën e ekspertit të komunikacionit Msc. Xh. H. të dt.25.11.2020, dhe edhe në eksperizën e ekspertit të komunikacionit Dr.sc.N. D. të dt.06.07.2022, meqë edhe këta ekspertë , kanë konkluduar se tejkalimi I shpejtësisë nga ana e drejtuesit të automjetit të markës “...” I ka kontribuar aksidentit në fjalë, por derisa grupi I ekspertëve në përbërje prej ekspertëve: Msc. F. S., Dr.sc. G. H. dhe Dr.sc. V. B., të dt.15.02.2021, kanë ardh në përfundim se përveq tejaklimit të shpejtësisë së automjetit të markës “...”kontribut në aksident ka patur edhe ka patur edhe drejtuesi I traktorit duke lëvizur pa sinjalizim, dhe poashtu edhe eksperti I komunikacionit Msc. Xh. H., në mendimin e tij përfundmitar ka konstatuar poashtu se aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve të të dy pjesëmarrëse në trafik , të përfshirë në aksident, në rastin konkret, drejtuesit të traktorit të markës “..”dhe drejtuesit të automjetit të markës “...”duke I kualifikuar si lëshime primare dhe sekondare, eksperti I komunikacionit Msc. F. H., në mendimin e tij profesional lidhur me aksidentin ka vlerësuar se aksidenti në fjalë është shkaktuar vetëm nga lëshimet e drejtuesit të traktorit të markës “..” për shkak drejtimit të traktorit pa sinjalizimin e duhur, kurse eksperti I komunikacionit, Dr.sc.N. D. në mendimin e tij përfundmitar, ka vlerësuar se aksidenti I komunikacionit është shkaktuar vetëm nga lëshimet e drejtuesit të automjetit të markës “...” I cili nuk ka respektuar shpejtësinë e kufizuar të lëvizjes, në pjesën e rrugës ku ka ndodhur aksidenti.

Pra, bazuar në të lartëcekurat, të gjithë këta ekspertë, kanë konstatuar si lëshim, lëvizjen pa sinjalizim të drejtuesit të traktorit në kushte të natës dhe tejkalimin e shpejtësisë së automjetit të markës “...”, derisa eksperti I komunikacionit Msc. F. H., në mendimin e tij lidhur me aksidentin e ka vlerësuar si lëshim vetëm lëvizjen pa sinjalizim të drejtuesit të traktorit, kurse

eksperti I komunikacionit, Dr.sc.N.D., në mendimin e tij e ka vlerësuar si lëshim vetëm tejkalimin e shpejtësisë të automjetit të markës “...”. Dhe bazuar në këto ekspertiza, mendimet e ekspertëve, Msc F. H. dhe Dr.sc. N.D., nuk dallojnë në konstatimin e lëshimeve, por në konstatimin se cili prej këtyre lëshimeve I ka kontribuar aksidentit.

Gjithsesi duke qenë se, gjykata në rastin konkret posedon dy mendime profesionale të dy grupeve të ekspertëve të komunikacionit, të cilat, konstatojnë se aksidenti ka ndodhur me lëshimet e të dy pjesëmarrësve të përfshirë në aksident, të sqaruara edhe përmes ekspertit Prof.dr.N. L., gjykata u fali besimin vetëm pjesërisht këtyre ekspertizave, pra të ekspertëve të komunikacionit : Msc F. H. dhe Dr.sc. N. D..

Nga raporti I autopsisë I lëshuar nga Instituti I Mjekësisë Ligjore me nr. ref.MA20-284 të dt. 23.11.2020, konstatohet se vdekja aksidentale me dt.15.10.2020, e tani të ndjerit M. L., në rastin konkret drejtues I automjetit të markës “...”, është shkaktuar si rezultat I gjakderdhjes trurore dhe torakale, si pasojë e thyerjes serike complete të brinjve dhe dërrasës së gjoksit.

Nga fotografitë dhe skicimi I vendit të ngjarjes është konstatuar vendi I ndodhjes së aksidentit, derisa nga raporti I Qendrës Emergjente në kuadër të Spitalit të Përgjithshëm Ferizaj, gjykata konstaton se tani I ndjeri M. L ., me dt. 11.10.2020, pas një kontrolli mjekësor në këtë spital, të njëjtën ditë transferohet për në QKUK Prishtinë.

Pas prezantimit të provave dhe vlerësimit të tyre te plotë, secilën veç e veç dhe të gjitha në tërësi, mbrojtjes se të pandehurit si dhe bindjes së lirë të gjykatës, gjykata vërtetoi gjendjen faktike si ne dispozitiv.

Gjykata u dha besimin provave të adminstruara, sepse me të njëjtat ne mënyrë të qartë dhe bindëse është përshkruar koha,vendi dhe mënyra e kryerjes së veprës penale, dhe se këto prova gjejnë mbështetje në njera tjetrën dhe pjesërisht edhe në vetë mbrojtjen e të pandehurit.

Gjykata vlerësoi posaçërisht edhe mbrojtjen e të pandehurit, ku i njëjti thot I njeti thekson se , duke qenë se ditën kritike e ka patur të vendosur në rimorkion e traktorit, si sinjalizim për pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, nje kесе të verdhë të najlonit, ka vlerësuar se kjo ka qenë e mjaftueshme për sinjalizim, mirëpo një mbrojtje të tillë gjykata nuk I fali besimin, meqë duke

patur parasysh edhe faktin se I njejt, në kohën për të cilën bëhet fjalë ka qenë edhe I pajisur me patent shofer të kategorisë “B”, është e pritshme nga I njejt që të ketë qenë në dijeni për sinjalizimin adekuat të traktorit në rastin konkret.

Ndërsa me rastin e vlerësimit të mbrojtjes së të pandehurit të dhënë përmes mbrojtësit të tij, gjykata pati parasysh pretendimin e mbrojtjes se aksidenti I dates 11.10.2020 nuk është shkaktuar nga veprimi apo mosveprimi I të mbrojturit të tij, por është shkaktuar nga tejkalimi I shpejtësisë edhe mos reagimi me kohë me sistem të frenimit të drejtuesit të automjetit të markës “...” sepse, në të kundërtën nuk do të vinte fare deri te aksidenti, si dhe pretendimin e tij se tek I mbrojturi I tij nuk ka ekzistuar dashja eventuale për kryerjen e kësaj veprë penale, meqë nga të gjitha deklaratimet e tij vërehet qartë se I njejt kishte vendosur një najlon të verdhë mbrapa rimorkios e cila tërhiqej me traktor, derisa një dashje e tillë ka ekzistuar tek drejtuesi I automjetit të markës “...”, tani I ndjerë, I cili me tejkalimin e shpejtësisë prej 60km/h në 75 km/h, ka parë një probabilitet të madh si të mundshëm në shkaktimin e mundshëm të pasojës, megjithatë ka vazhduar duke mos hequr dorë në drejtimin e mjetit me shpejtësi mbi 75 km/h.

Se , tani I ndjeri ka tejkaluar shpejtësinë e lëvizjes, kjo tashmë është konstatuar edhe nga ekspertizat e urdhëruara në fazën e hetimeve, por edhe superekspertiza e dt.22.09.2023, mirëpo kjo nuk e përjashton përgjegjësinë e të pandehurit, I cili me daljen në komunikacion, në rrugë magjistrale në kushtet e natës pa sinjalizimin e duhur, ka krijuar rrezik të përgjithshëm për pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, e në rastin konkret me këtë veprim të tij, nga pakujdesia , ka kontribuar në aksidentin në fjalë.

Pretendimi I mbrojtësit se në rastin konkret ka ekzistuar dashja eventuale te drejtuesi I automjetit të markës “...”dhe jo tek I mbrojturi I tij, është fakt I cili nuk mund të konstatohet në këto rrethana, meqë do të ishte e padrejtë që të njejt (tani të ndjerit) t’I atribuohet një element subjektiv I tillë, kur dihet se I njejt për shkak të lëndimeve të pësuar si pasojë e aksidentit ka ndërruar jetë pa dhënë ndonjë deklaratë, dhe aq më shumë kur tejkalimi I shpejtësisë së të njejt, bazuar në shpejtësin e lejuar dhe atë të zhvilluar (konstatuar nga eksperti) nuk ka qenë më shumë se 15 km/h, si dhe duke patur parasysh faktin se traktori nuk ka patur sinjalizimin e duhur, pra nuk është se tani I ndjeri e ka injoruar prezencën e traktorit në rrugë. Andaj, tani I ndjeri me veprimin e mosrepsektimit e kufizimit të shpejtësisë në atë pjesë të rrugës, sikurse edhe I pandehuri me mosrepsektimin e rregullave për sinjalizim, kanë

krijuar rrezik të përgjithshëm në komunikacion, meqë ekziston korrelacioni apo lidhja shkakësore mes veprimeve të tyre dhe pasojës së shkaktuar.

Bazuar në kualifikimin e kësaj vepre penale, mund të konsatohet se kjo vepër penale, kryhet për shkak të mosrespektimit të dispozitave ligjore të ligjeve që rregullojnë trafikun public, duke vënë në rrezik jetën ose integritetin trupor të njerëzve a pasurisë.

Përkitazi me fajësinë, ligji parashikon që kjo vepër penale kryhet nga pakujdesia. Bazuar në të gjitha provat e adminstruara në rastin konkret, gjykata konstaton se vepra penale është kryer nga pakujdesia dhe se kontribut për shkaktimin e aksidentit ka patur I pandehuri nga mosrespektimi I dispozitave ligjore lidhur me sinjalizimin si dhe tani I ndjeri me mosrepsektimin e shenjës së trafikut e cila ka kufizuaar shpejtësinë e lejuar në atë pjesë të rrugës, dhe se normalisht në rastin konkret, lëshimet e tani të ndjerit, ndikojnë në shkallën e përgjegjësisë penale të drejtuesit të traktorit dhe në llojin dhe masën e sanksionit penal.

Gjykata pas analizimit të mbrojtjes së të pandehurit në rastin konkret, vlerëson se ky I fundit arsyetimin se nuk kishte kontribut në aksidentin në fjalë, e ka bërë duke tentuar që t'I shmanget përgjegjësisë penale për rastin konkret.

Nisur nga të gjitha këto fakte të vërtetuara ne procedurë, gjykata vërtetoi se ne veprimet e të pandehurit, manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370 par. 9 lidhur me par. 1 dhe 6 të KPRK-së.

Me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 70 të KPK-së, kështu që në rastin gjykata pati parasysh si rrethanë lehtësuese faktin se kontribut në aksidentin në fjalë ka patur edhe vetë I dëmtuari, tani I ndjerë, faktin se I pandehuri, bazuar në evidencën e gjykatës, nuk ka patur raste të tjera penale dhe jo vetëm të kësaj natyre, shprehja e keqardhjes nga ana e tij, pavarësisht faktit që nuk e ndien veten fajtor për aksidentin, fakti që familja e te ndjerit, nuk i janë bashkangjitur ndjekjes penale, ndërsa rrethanë të posaçme rënduese gjykata gjeti shkallën e lartë të dëmit të shkaktuar ku si pasojë ne rastin konkret ka humbur jeten një person, tani i ndjeri M.L.

Andaj, gjykata për këto arsye, të pandehurin S.K, i akuzuar për veprën penale, Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370 par. 9 lidhur me par. 1 dhe 6 të KPRK-së, e gjykoi me dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me

veprën si dhe sjelljen e te pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë tek i pandehuri dhe personat tjerë që të shmangen nga kryerja e veprave penale, dhe të forcojë detyrimin për respektimin e ligjit, dhe me këtë edhe të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit, i paraparë në nenin 38 të KPK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nenpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhezimin e të dëmtuarit në contest civil u mor konform nenit 462 par.2 të KPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.nr. 73/21 datë 22.03.2024

Sekretarja Juridike
Indira Beqa

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.